

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-4135-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimi për mirëmbajtje dhe përmirësime në Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK).**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Tretek SH.P.K.
NUI	810853821
Adresa	Rr.Astrit Rrushi Obj.Pika Mati 1
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	+38349642227
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lirim Sulejmani
Adresa elektronike	tretekshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	24.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontratë – 03.06.2026**
- **Proces verbali i hapjes së Tenderëve – 29.06.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 14.07.2026**
- **Kërkesa për rishqyrtim – 17.07.2026**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – 26.07.2026**
- **Vendimi i OSHP 546/26 – 04.09.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 21.09.2026**
- **Kërkesa për rishqyrtim – 22.09.2026**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – 23.09.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Jemi njoftuar përmes platformes elektronike të prokurimit publik me hapjen e tenderëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues në raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 - Dosja e Tenderit

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 131 - Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Bazuar në dispozitat e nenit 109(2) të LPP-së, parashtrojmë këtë **Ankesën e dytë (2)** ndaj Vendimit të AK-së i pranuar nga OE me datën 21-09-2026 ("**Vendimi i Ankimuar**") përmes së cilit është Refuzuar Kërkesa me datë 23-09-2026 në kuptim të së cilës është propozuar kthimi i tenderit në ri-vlerësim ashtu siç kishte paraparë OSHP me vendimin **nr. 2026/0546**.

Kjo ankesë paraqitet pasi AK, gjatë procesit të rivlerësimit, **nuk i ka korrigjuar parregullsitë e konstatuara me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0546**, por ka bërë një interpretim të ri dhe më të gjerë të kërkesës së Dosjes së Tenderit, duke arritur në përfundimin e kundërt mbi të njëjtat dokumente të cilat paraprakisht janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së.

Në këtë kuadër, theksojmë pretendimet tona:

PRETENDIMET ANKIMORE

1. MOSZBATIMI I VENDIMIT TË OSHP-së NR. 2026/0546

Me Vendimin nr. 2026/0546 të datës 04.09.2026, OSHP ka **aprovuar si të bazuar** ankesën e TRETEK SH.P.K., ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim. Në kuadër të këtij vendimi, Paneli Shqyrtues ka administruar raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresat, dokumentet dhe të gjitha provat e rastit. Pas shqyrtimit të tyre, Paneli ka deklaruar shprehimisht se **i jep besim të plotë ekspertit shqyrtues**, ka konstatuar se raporti është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban analizën e pretendimeve dhe dispozitave të shkelura, dhe si rrjedhojë ka mbështetur rekomandimin e ekspertit dhe ka aprovuar ankesën si të bazuar.

Sa i përket pikërisht kriterit për Menaxherin e Projektit, eksperti shqyrtues ka konstatuar se diploma e dorëzuar për z. A.V., me titull **“Baçelor i shkencave të inxhinierisë kompjuterike”** nuk është në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit, sepse fusha e Inxhinierisë Kompjuterike dhe fusha e Shkencave Kompjuterike nuk janë të njëjta.

Eksperti ka shqyrtuar gjithashtu dokumentet Microsoft të dorëzuara për të njëjtin person dhe ka konstatuar se ato **nuk janë certifikime profesionale përfundimtare**, por module trajnimi që dëshmojnë ndjekjen e trajnimeve të caktuara dhe jo marrjen e një certifikimi profesional në fushat e kërkuara.

Përfundimi i ekspertit ka qenë i qartë ***Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, OE i rekomanduar sa i përket menaxherit të projektit nuk i ka përmbushur në tërësi kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.***

Provë: RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES / 10.08.2026

Ky konstatim nuk ka mbetur thjesht opinion i ekspertit. Ai është administruar, shqyrtuar dhe **mbështetur nga Paneli Shqyrtues në Vendimin nr. 2026/0546.**

Provë: OSHP: 2026/0546/ 04.09.2026

Prandaj, qëllimi i rivlerësimit nuk ka qenë që AK të rikthehet tek e njëjta çështje faktike, të shqyrtojë të njëjtën diplomë dhe të njëjtat dokumente Microsoft dhe pastaj të ndërtojë një interpretim të ri për të arritur në rezultatin e kundërt.

Qëllimi i rivlerësimit ka qenë **korrigjimi i parregullsive ligjore të konstatuara nga OSHP.**

Neni 40.2.1 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton shprehimisht *Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHPsë, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHPsë. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve.*

2. AK KA NDRYSHUAR INTERPRETIMIN E KRITERIT PAS HAPJES SË OFERTAVE

Dosja e Tenderit ka kërkuar për Menaxherin e Projektit:

“Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike ose certifikime profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të dhënave”

Kjo kërkesë përmban dy alternativa të përcaktuara:

Alternativa 1: diplomë universitare në fushën e Shkencave Kompjuterike; ose

Alternativa 2: certifikime profesionale Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të dhënave.

Pas rivlerësimit, AK ka krijuar një interpretim të ri sipas të cilit termi **“fusha e shkencave kompjuterike”** duhet kuptuar shumë gjerë dhe duhet të përfshijë edhe drejtime të tjera të cilat kanë komponentë të kompjuterikës në programin e tyre.

Një standard i tillë **nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit.**

Dosja nuk ka kërkuar:

- “Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme”;
- “Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike”;
- “IT, Inxhinieri Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike apo ekuivalente”;

Përkundrazi, AK vetë e ka përcaktuar kriterin konkretisht si **“diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike”**.

Sipas nenit **17.12 të Rregullores**, *Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjalë në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Në rast se AK organizon vizite në vendpunishte apo konference para-ofertuese, pjesëmarrja e OE në vizite në vend-punishte/konference para-ofertuese nuk duhet të jete obligative. Vizita në vend-punishte/konference para-ofertuese organizohet për OE dhe është në të mirën e tyre, pra është ndihmese për OE.*

Nuk mund të krijohet ky standard vetëm pas hapjes së ofertave dhe pasi OSHP ka konstatuar se dokumentet e OE të rekomanduar nuk e përmbushin kriterin.

Edhe më drejtpërdrejt, **neni 40.2 i Rregullores** përcakton se tenderët duhet të vlerësohen sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit dhe se *Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriterë ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

Kriterin në DT ka qenë **“diplomë në fushën e shkencave kompjuterike”** dhe nuk mund të shndërrohet pas hapjes së ofertave në **“çdo diplomë nga një drejtim që përmban komponentë të kompjuterikës”**.

Kjo do të nënkuptonte ndryshimin e rregullave të vlerësimit pasi tenderuesit tashmë kanë dorëzuar ofertat e tyre.

3. TITULLI “BAÇELOR I SHKENCAVE TË INXHINIERISË KOMPJUTERIKE” NUK ËSHTË I NJËJTË ME “SHKENCA KOMPJUTERIKE”

Në rivlerësim, AK i ka dhënë rëndësi faktit që diploma e z. A.V. përmban formulimin **“Bachelor i shkencave të inxhinierisë kompjuterike”**. Mirëpo këtu përzihen dy elemente të ndryshme të titullit akademik:

“Bachelor i shkencave” është titulli/lloji i gradës akademike;

ndërsa

“Inxhinieri Kompjuterike” është fusha/drejtimi i studimit.

Prania e fjalës “shkencave” brenda formulimit “Bachelor i shkencave” nuk e transformon fushën e studimit nga **Inxhinieri Kompjuterike** në **Shkenca Kompjuterike**.

Sikur të pranohej logjika e AK-së, atëherë çdo diplomë me titullin **“Bachelor of Science”**, pavarësisht disiplinës konkrete, do të mund të konsiderohej diplomë në **“Shkenca Kompjuterike”**.

Një interpretim i tillë do ta bënte pa kuptim faktin që Dosja e Tenderit ka përcaktuar një **fushë konkrete studimi**.

Pikërisht këtë dokument e ka shqyrtuar eksperti shqyrtues në lëndën **nr. 2026/0546** dhe ka konstatuar se:

- fusha e Inxhinierisë Kompjuterike dhe ajo e Shkencave Kompjuterike nuk janë të njëjta;
- diploma e A.V. nuk e përmbush alternativën e parë të kriterit;
- dokumentet Microsoft të paraqitura nuk e përmbushin as alternativën e dytë;
- rrjedhimisht, kriteri për Menaxherin e Projektit nuk është plotësuar.

Paneli Shqyrtues më pas ka vendosur t'i japë besim të plotë këtij raporti.

Prandaj, AK nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo dokument të ri që do të mund të justifikonte ndryshimin e këtij përfundimi.

4. OE “CMD” SH.P.K. NUK MUND TË KONSIDEROHET TENDERUES I PËRGJEGJSHËM PA PËRMBUSHUR KITERIN

Kërkesa për Menaxherin e Projektit është pjesë e **kapacitetit teknik dhe profesional** dhe përbën kriter të përzgjedhjes sipas Dosjes së Tenderit.

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime*

materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Po ashtu, **neni 40.6 i Rregullores:** *Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit*

Në këtë rast, alternativa e parë e kriterit nuk është përmbushur sipas konstatimit të ekspertit, sepse diploma është në Inxhinieri Kompjuterike.

Alternativa e dytë nuk është përmbushur sepse dokumentet Microsoft janë konstatuar se janë module trajnimi dhe jo certifikime profesionale përfundimtare në fushat e kërkuara.

Përderisa nuk është përmbushur asnjëra nga dy alternativat, nuk ekziston baza juridike që kjo kërkesë të konsiderohet e plotësuar.

Përgjegjshmëria e një tenderi nuk mund të krijohet duke **zgjeruar interpretimin e kriterit pas dorëzimit të ofertave.**

Kjo bie ndesh edhe **nenin 7 i LPP-së** kërkon *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Nëse operatorët e tjerë ekonomikë kanë përgatitur ofertat duke respektuar DT konkretisht formulimin e publikuar të kriterit, OE i rekomanduar nuk mund të trajtohet sipas një formulimi më të gjerë të krijuar vetëm gjatë rivlerësimit.

5. MOSRESPEKTIMI I KONSTATIMEVE TË OSHP-së

Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0546 nuk është kufizuar në një urdhër formal që AK “ta shikojë edhe një herë” ofertën.

Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar pikërisht pretendimin lidhur me Menaxherin e Projektit dhe ka mbështetur konstatimin e ekspertit se kriteri nuk është përmbushur.

Kemi të bëjmë me:

- të njëjtin aktivitet të prokurimit;
- të njëjtin Autoritet Kontraktues;
- të njëjtin OE ankues;
- të njëjtin OE të rekomanduar;
- të njëjtin Menaxher Projekti;
- të njëjtën diplomë;
- të njëjtat dokumente Microsoft;
- të njëjtin kriter të Dosjes së Tenderit;
- dhe të njëjtën çështje materiale: **a e përmbush apo jo personi i propozuar kriterin e përcaktuar në DT.**

Gjendja faktike mbi këtë pikë nuk ka ndryshuar.

Për këtë arsye kërkojmë që OSHP të shqyrtojë zbatueshmërinë e **nenit 105 paragrafi 2.16 të LPP-së**, sipas të cilit: *Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.*

E njëjta dispozitë është përsëritur edhe në **nenin 67.1 të Rregullores për Prokurimin Publik**.

Veç kësaj, Vendimi nr. 2026/0546 ka paralajmëruar shprehimisht AK-në për respektimin të vendimit dhe nenin 131 të LPP-së.

Neni 131 i LPP-së përcakton: *OSHP-ja do të vendosë një gjobë prej jo më pak se pesëmijë (5.000) Euro për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mosrespektimin e urdhrit të OSHP-së brenda pesë (5) ditëve.*

Në rrethanat konkrete, konsiderojmë se ekziston bazë që OSHP të vlerësojë jo vetëm ligjshmërinë e rezultatit të ri të rivlerësimit, por edhe nëse veprimi i AK-së përbën **zbatim real apo mosrespektim material të Vendimit nr. 2026/0546**.

Duke u bazuar në faktet, provat dhe dispozitat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

- ta aprovojë **si të bazuar** ankesën e TRETEK SH.P.K. dhe ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 21.09.2026;
- të urdhërojë AK-në që ta zbatojë plotësisht Vendimin nr. 2026/0546, ta trajtojë çështjen si të gjykuar **“res judicata”** sipas dispozitave përkatëse të LPP-së dhe të vazhdojë procedurën me tenderuesin e radhës që i plotëson kërkesat e DT.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.
- **Shpenzimet për sigurimin e tenderit:** për shkak të zgjatjes dhe përsëritjes së procedurës, TRETEK SH.P.K. është detyruar të sigurojë/vazhdojë sigurimin e tenderit dy herë, duke bartur kosto shtesë financiare dhe bankare që nuk do të ishin shkaktuar nëse procedura do të ishte zhvilluar dhe përfunduar në përputhje me dispozitat ligjore.
- **Fitimet e pritura:** Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) Raporti i ekspertit shqyrtues - 10.08.2026
- i) Vendimi i OSHP 2026/0546 – 04.09.2026

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.